

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010), dhe nenet 49 dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11 / 11 maj 2012, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016 miratoi

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT KREDITOR

KAPITULLI I DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e standardeve dhe kërkesave minimale për menaxhimin e rrezikut kreditor, duke përfshirë vendosjen e standardeve minimale për vlerësimin e rrezikut kreditor dhe sistemin e klasifikimit për të gjitha ekspozimet kreditore, si dhe minimumin e kërkesave për provizionim.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2 Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në Nenin 3 të ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare" (në vijim: *Ligji për banka*), dhe/ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - a. *Kreditë me vonesa* definoohen si kredi të klasifikuara në kategoritë e klasifikimit të kredive si: vrojtuese, nën standard, të dyshimta dhe humbje.
 - b. *Kreditë e klasifikuara* definoohen si kredi të klasifikuara në kategoritë e klasifikimit të kredive si: nën standard, të dyshimta dhe humbje.
 - c. *Kreditë jopërformuese* definoohen si kredi të klasifikuara në kategoritë e klasifikimit të kredive si: të dyshimta dhe humbje.

- d. *Ekspozimet kreditore të ri-programuara* janë ato ekspozime kreditore të cilave ju ndryshohen kushtet kontraktuale për shkak të përkeqësimit të gjendjes financiare të klientit, që ndër të tjera përfshinë:
 - zgjatja e maturitetit; ose
 - konsolidimi i më shumë se një ekspozimi kreditor në një ekspozim të vetëm duke ndryshuar kushtet kontraktuale.
- e. *Interesi në vonesë* është përcaktuar si interes i cili nuk është paguar para se kredia të ri-programohet, duke përfshirë interesin e rregullte në vonesë, interesin ndëshkues dhe interesat tjera të lidhura me kredinë;
- f. *Stres testi* është procesi i përcaktimit të efekteve në portofolin e kredive nga aplikimi i situatave ekstreme të simuluar përmes përdorimit të të dhënave reale dhe supozimeve.
- g. *Vlera reale e tregut* është çmimi me të cilin një pasuri mund të shitet në tregun e hapur, të lirë, me vullnet të lirë të blerësit dhe shitësit dhe pa presion të ushtruar në asnjërin prej tyre.
- h. *Performancë e qëndrueshme* nënkupton katër pagesa me radhë, të kryegjësë dhe të interesit, sipas planit të pagesës.
- i. *Hipoteka* do të thotë krijimi i interesit në pasurinë e paluajtshme me anë të marrëveshjes apo ligjit, që kreditorit të hipotekës (pengmbajtësit) i jep të drejtën të iniciojë procedurën për heqjen e të drejtës mbi pronën e vënë në hipotekë për pasurinë e tillë të paluajtshme, me qëllim të përmbushjes së një detyrimi që është siguruar me hipotekë dhe që duhet të paguhet.
- j. *E drejta e pengut* (pengu) do të thotë krijimi i ndonjë interesi mbi pasurinë e luajtshme ose mbi ndonjë të drejte me anë të marrëveshjes ose me anë të ligjit, i cili i jep pengmarrësit të drejtën për ta marrë në posedim atë pasuri ose për ta shfrytëzuar atë të drejtë me qëllim të përmbushjes së ndonjë obligimi ekzistues dhe të identifikueshëm që është siguruar me anë të pengut.

KAPITULLI II

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT KREDITOR

Neni 3

Sistemi i Menaxhimit të Rrezikut Kreditor

1. Bankat duhet të kenë një sistem për menaxhimin e rrezikut kreditor, që është i përshtatshëm për natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e aktiviteteve të tyre.
2. Sistemi i menaxhimit të rrezikut kreditor në banka duhet të përfshijë politikat, procedurat, rregullat dhe strukturën të cilat përdoren nga bankat për të menaxhuar rrezikun kreditor.

3. Sistemi i menaxhimit të rrezikut kreditor duhet që në mënyrë të vazhdueshme dhe me kohë të bëjë vlerësimin e kualitetit të kredive dhe mjeteve tjera, duke përfshirë edhe përcaktimin e adekuatshmërisë së rezervave për humbjet që lidhen me këtë rrezik.

Neni 4 **Strategji dhe Politikë**

1. Banka duhet të zhvillojë strategji dhe politikë për të menaxhuar rrezikun kreditor. Strategjia dhe politika për menaxhimin e rrezikut kreditor duhet të komunikohen në mënyrë efektive në tërë bankën. I gjithë personeli përkatës duhet qartë të kuptojnë qasjen e bankës për dhënie dhe menaxhimin e kredive dhe duhet të mbahen përgjegjës për pajtueshmëri me politikën dhe procedurat e përcaktuara.
2. Qëllimi bazë i strategjisë së rrezikut kreditor është të përcaktojë oreksin e bankës për rrezik. Pasi niveli i rrezikut të jetë vendosur, banka mund të zhvillojë një plan për të optimizuar kthimin duke e mbajtur rrezikun kreditor brenda kufijve të paracaktuar. Strategjia e rrezikut kreditor duhet të përbëhet në minimum nga:
 - a. Deklarata e gatishmërisë së bankës për të dhënë kredi bazuar në segmente të ndryshme të huamarrësve dhe të produkteve, të tipit të ekspozimit (tregtare, të prodhimit, të konsumit, pasurive të patundshme, etj.), sektori ekonomik, vendndodhja gjeografike, valutës, afatit të maturimit dhe profitabilitetit të parashikuar;
 - b. Identifikimi i tregjeve të synuara dhe karakteristikat e përgjithshme që banka planifikon t'i arrijë në portofolin e saj të kredisë, duke përfshirë nivelet e diversifikimit dhe tolerancën e koncentrimit;
 - c. Njohja me objektivat e kualitetit të kredive, fitimeve dhe rritjen;
 - d. Të sigurojë vazhdimësinë në qasjen që duhet të marrë parasysh aspektet ciklike të ekonomisë dhe lëvizjeve që rezultojnë në përbërjen dhe kualitetin e portofolit të kredive.
3. Strategjia e rrezikut kreditor duhet të rishikohet në baza të rregullta, të paktën një herë në vit.
4. Politika për menaxhimin e rrezikut kreditor duhet të rishikohet në baza të rregullta, të paktën një herë në vit dhe së paku duhet të përfshijë elementet vijuese:
 - a. Misionin;
 - b. Përcaktimin e llojeve të pranueshme dhe të papranueshme të ekspozimeve kreditore;
 - c. Kufizimi i totalit të kredive aktive në raport me mjetet totale, depozitat apo kapitalin;
 - d. Kombinimi i portofolios së dëshiruar;
 - e. Shpërndarja e portofolios sipas afatit të maturimit të kredive;
 - f. Segmentimi i definuar i tregut;
 - g. Kushtet e huadhënies: çmimi, afati i kthimit, dhe pagesat paraprake/kërkesat kapitale;
 - h. Informatat financiare të kërkuara;
 - i. Përkufizimi i një huamarrësi të kualifikuar për kredi;
 - j. Kolaterali i pranueshëm dhe margjinat;
 - k. Autoritetet e huadhënies dhe procesi i aprovimit;
 - l. Kufizimet mbi ekspozimet e mëdha;
 - m. Limitet për zyrtarë kreditor lidhur me portofolin e tyre kreditor;
 - n. Ekspozimet e personave të brendshëm dhe interesat e ndërlidhura të tyre;

- o. Udhëzime për ri programim të kredive;
- p. Raporte të brendshme lidhur me menaxhimin e rrezikut kreditor;
- q. Organizimi i funksionit të huadhënies;
- r. Udhëzime për blerjet dhe shitjet e kredive me pjesëmarrje të përbashkët të institucioneve financiare.

Neni 5

Struktura Organizative për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor

1. Banka duhet të krijojë një strukturë të përshtatshme organizative për menaxhimin e rrezikut kreditor, duke përcaktuar qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese.
2. Banka duhet të sigurojë që funksioni i shitjes së kredive, të jetë i ndara në mënyrë të qartë, nga pikëpamja organizative dhe operative, nga funksionet mbështetëse operationale dhe ato të kontrollit të rrezikut kreditor, duke përfshirë mbrojtjen nga ndikimet e mundshme nga nivelet e larta drejtuese.
3. Banka duhet të sigurojë strukturën e nevojshme për vlerësimin, matjen dhe kontrollin e koncentrimin të rrezikut kreditor sipas sektorëve, sipas shtrirjes gjeografike / lokacionit, sipas valutës, llojit të kredisë, etj.
4. Bordi i drejtorëve i bankave, në lidhje me menaxhimin e rrezikut kreditor është përgjegjës të:
 - a. Miratojë strategji të rrezikut kreditor;
 - b. Miratojë politikën për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe të monitorojë zbatimin e saj;
 - c. Rishikojë përshtatshmërinë e politikës dhe procedurave të aprovuara, të paktën në baza vjetore;
 - d. të rishikojë raportet e rrezikut kreditor:
 - i. Të paktën çdo tremujor, bordi i drejtorëve duhet të informohet mbi ekspozimet e rrezikut kreditor (duke përfshirë edhe zërat jashtë-bilancor) të bankës dhe duhet të rishikojë, në minimum këto:
 - Shumën e ekspozimeve të ndërmarra në aktivitetet e kredive, të ndara sipas kategorive (llojin e ekspozimit, produkteve dhe kategorinë e klasifikimit);
 - Ekspozimet e mëdha kreditore;
 - Listën e kredive me vonesa e cila identifikon problemet dhe humbjet e mundshme të bankës për çdo kredi të rëndësishme;
 - Statusi i kredive të ri programuara;
 - Kreditë me rritje shumë të lartë dhe të shpejtë në portofolin kreditor;
 - Raportet mbi përjashtimet e kredive nga politikat dhe procedurat;
 - ii. Në baza vjetore, bordit të drejtorëve duhet t'i dorëzohet një raport që përmban një listë të të gjitha produkteve kreditore. Raporti duhet të përmbajë, në minimum tregjet e synuara të produkteve kreditore, performancën e tyre dhe kualitetin e kredive;
 - iii. Në bazë vjetore apo më shpesh, bordi i drejtorëve duhet të rishikojë rezultatet e *stres testit* për:

- Përmirësimin e strategjisë dhe politikën e menaxhimit të rrezikut kreditor;
 - Hartimin dhe përmirësimin e kornizës së kërkuar rregullative (ligjore) për të adresuar çështjet kryesore që lidhen me ekspozimet e rrezikut kreditor;
 - Parashikimin në kohën e duhur të kërkesave për rritjen e kapitalit dhe identifikimin e mënyrave më të efektshme për akumulimin e tij.
- e. Aprovojë limite të ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor, në përputhje me rregulloren e BQK-së mbi ekspozimet e mëdha;
- f. Definojë përjashtimet e mundshme prej limiteve të përcaktuara dhe të caktojë përgjegjësinë për të vendosur në rastet e aplikimeve të përjashtimeve të tilla;
- g. Monitorojë efikasitetin e kontrolleve të brendshme, si pjesë përbërëse e sistemit të menaxhimit të rrezikut kreditor.
5. Komiteti i menaxhimit të rrezikut duhet të:
- a. Monitorojë politikën e menaxhimit të rrezikut kreditor dhe të japë propozime për rishikimin e vazhdueshëm të saj;
 - b. Vlerësojë sistemin e menaxhimit të rrezikut kreditor;
 - c. Analizojë raportet mbi ekspozimet e bankës ndaj rrezikut kreditor dhe të monitorojë menaxhimin e këtij rreziku;
 - d. Përcaktojë dhe rishikojë rregullisht treguesit e brendshëm kreditor dhe limitet e ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor;
 - e. bëjë përkthim të qartë të linjave të autoritetit dhe përgjegjësisë për menaxhimin e rrezikut kreditor.
6. Menaxhmenti i bankës duhet të:
- a. Aprovojë dhe monitorojë zbatimin e procedurave të menaxhimit të rrezikut kreditor;
 - b. Krijojë një ambient për përcjelljen e politikës së menaxhimit të rrezikut kreditor;
 - c. Krijojë një sistem adekuat të raportimit te bordi i drejtorëve dhe komiteti i menaxhimit të rrezikut për çdo mos pajtueshmëri me limitet e ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor;
 - d. Krijojë kanale të duhura të komunikimit për të siguruar se politika për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe tolerancat e rrezikut kreditor janë komunikuar qartë dhe respektohen nga nivelet e përshtatshme të bankës;
 - e. Sigurojë procedura operacionale adekuate dhe efektive, kontrollë të brendshme dhe sisteme për identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut kreditor për të zbatuar politikat e menaxhimit të rrezikut kreditor të aprovuara nga bordi i drejtorëve;
 - f. Sigurojë proces gjithëpërfshirës të raportimit të rrezikut kreditor;
 - g. Krijojë një sistem informativ efektiv të menaxhmentit për të siguruar raportim të saktë, me kohë dhe informativ mbi ekspozimet e rrezikut kreditor;
 - h. Sigurojë burime të mjaftueshme dhe personel kompetent për të menaxhuar dhe kontrolluar operacionet e përditshme dhe në mënyrë efektive funksionet e menaxhimit të rrezikut kreditor;
 - i. Kryejë në mënyrë periodike një vlerësim të pavarur të funksionit të lejimit të kredive të bankës.

Neni 6 Stres Testi

1. Banka, përmes *stres testit* do të vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme dhe adekuate ekspozimin e saj ndaj rrezikut kreditor, duke pasur parasysh ndryshimet e mundshme në të ardhmen, të faktorëve të rrezikut që ndikojnë në kualitetin e portofolit të kredive dhe në situatën financiare të bankës, pasi ajo ndikon në fitimin neto dhe në treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit.
2. Banka duhet të përcaktojë periudhat e kryerjes së *stres testeve*, së paku në baza vjetore, si dhe raportimin e rezultateve në strukturat e menaxhmentit të lartë, në përputhje me madhësinë e veprimtarisë, të dhëna për ekspozimet ndaj rrezikut kreditor dhe pjesëmarrjen e tyre në sistemin bankar. BQK-ja mund të kërkojë nga bankat për të kryer *stres teste* në periudha më të shpeshta dhe/ose sipas skenarëve me supozime shtesë dhe /ose të ndryshme.
3. *Stres testet* e kryera nga banka duhet të paktën të përfshijnë përdorimin e skenarëve të veçantë dhe/ose të kombinuar, të bazuar në faktorë të tillë siç janë: rënia ekonomike, ndryshimi i shpejtë i kushteve të tregut (rreziku i tregut kushtëzuar nga luhatjet e kursit të këmbimit, normat e interesit, etj.), e cila mund të ketë efekte të pafavorshme në pagesën e rregullt të detyrimit (borxhit), apo skenarët e përkeqësimit të portofolit të kredive, pavarësisht përcaktimit të faktorëve të rrezikut që mund të shërbejnë si një arsye për paraqitjen e një situatë të pafavorshme.
4. Banka duhet të përcaktojë metodologjinë për realizimin e *stres testeve*, supozimet, si dhe veprimet që mund të ndërmerren duke marrë parasysh rezultatet, ku përfshihen:
 - a. zbatimi, analiza e skenarëve të *stres testeve* dhe periudhat e realizimit të tyre;
 - b. realizimi i *stres testeve* për skenarë të veçantë, individual dhe skenarë të kombinuar, në kushtet e shfaqjes së njëkohshme të disa skenarëve;
 - c. dokumentimi dhe rishikimi i rregullt i supozimeve të përdorura për kryerjen e *stres testeve*;
 - d. forma dhe periudhat e raportimit të rezultateve të *stres testeve* në strukturat menaxhuese;
 - e. veprimet që duhet të ndërmerren nga strukturat e menaxhmentit dhe/apo strukturat e veçanta të caktuara për menaxhimin e rrezikut kreditor, duke u bazuar në rezultatet e *stres testeve*.

KPITULLI III VLERËSIMI I KREDIVE, KLASIFIKIMI DHE NDARJA E REZERVËS PËR HUMBJET NGA KREDITË

Neni 7 Klasifikimi i Kredive

1. Bordi i drejtorëve është përgjegjës për miratimin e një politike të detajuar për klasifikimin dhe provizionimin e kredive.

2. Banka duhet të rishikojë të gjitha ekspozimet e rrezikut kreditor të paktën në bazë tremujore, përderisa klasifikimi dhe raportimi i kredive duhet të bëhet në baza mujore. Ekspozimet kreditore që vlerësohen individualisht, në shumë mbi 50,000 Euro kërkohet të rishikohen së paku në baza tremujore (periudha raportimit). Rishikimi së paku duhet të përfshijë: gjendjen në Rexhistrin e Kredive të Kosovës (RKK), ditët në vonesë dhe faktorë tjerë që mund të ndikojnë në performancën financiare të huamarrësit. Gjithashtu, kërkohet nga banka që të vlerësojë kualitetin e ekspozimeve kreditore nën 50,000 Euro së paku në baza vjetore. Ekspozimet kreditore që vlerësohen individualisht, në shumë mbi 50,000 Euro kërkohet të monitorohen së paku në baza gjashtëmujore (periudha e raportimit).
3. Klasifikimi i ekspozimeve kreditore duhet të bëhet sipas udhëzimeve të dhëna në vijim:
 - a. **Kreditë Standarde** përfshijnë të gjitha ekspozimet e rrezikut kreditor, duke përfshirë edhe ekspozimet jashtë-bilancore, që bartin rrezik normal bankar. Informacionet në dispozicion në lidhje me ekspozimet kreditore, performanca e llogarisë së klientit dhe të dhënat financiare, të gjitha tregojnë se pagesa e ekspozimit është mjaft e sigurt dhe pa vështirësi, (ose detyrimi është i siguar plotësisht me kolateral të pranueshëm, siç definohet në nenin 21 të kësaj Rregulloreje). Kredia është pa vonesa apo nëse vonesat janë më pak se 30 ditë nga data e kthimit ose maturimit të kredisë. Mbitërheqjet, linjat kreditore apo të ngjashme janë brenda limiteve të përcaktuara ose vetëm përkohësisht tejkalojnë limitin me më pak se 5 % (përqind), për më pak se tridhjetë ditë dhe rrjedha e parasë në llogari është e mjaftueshme për likuidimin e bilancit të mbitërheqjes, linjave kreditore apo të ngjashme brenda 30 ditëve nga data e skadimit të tyre.
 - b. **Kreditë Vrojtuese.** Ky klasifikim duhet të përdoret për të identifikuar dhe monitoruar ekspozimet, të cilat përmbajnë dobësi apo dobësi të mundshme, që në kohën e rishikimit, nuk e rrezikojnë kthimin e kredisë ose pasqyrojnë një potencial për ndonjë humbje, por në qoftë se nuk trajtohen apo përmirësohen, mund të rezultojnë në përkeqësim të kredisë për një klasifikim nën standard apo më ashpër. Në mungesë të ndonjë dëshmie të dokumentuar për të kundërtën, bankat duhet të klasifikojnë si "vrojtuese" ato ekspozime që janë vonuar nga 31 - 60 ditë si dhe ato me borxh të vazhdueshëm më të lartë se 5 përqind e linjave të aprovuara dhe me vonesë të tejkalimit të limitit prej 31 deri 60 ditë. Kjo kategori e klasifikimit ka për qëllim që t'iu mundësoj bankave për të identifikuar dhe trajtuar marrëdhëniet potencialisht të dobëta në një fazë të hershme. Ky klasifikim mund të përdoret gjithashtu për kreditë apo grupet e kredive, që janë të strukturuar dobët si rezultat i analizave të pamjaftueshme apo të njohurive teknike nga ana e nëpunësve kreditor. Kjo kategori nuk duhet të përdoret për ekspozimet, që kanë dobësi në dokumentacion e që nuk ndikojnë negativisht në potencialin e pagesës (shlyerjes) së ekspozimit.
 - c. **Kreditë nen standarde** përfshijnë ekspozimet të cilat bazuar mbi një rishikim të të gjithë faktorëve shoqëruar të kredisë, kanë definuar qartë dobësitë e kredisë që rrezikojnë kthimin e kredisë në rrjedhën normale. Një kredi nën standard është ajo kredi që, nga një analizë e të dhënave financiare dhe faktorë të tjerë përkatës, nuk është e mbrojtur aktualisht nga vlera e shëndoshë dhe kapaciteti i pagesës së huamarrësit ose garantuesit ose vlera e kolateralit të pranueshëm nëse ka. Kërkesa për pagesën e kredisë nga një garantues i përgjegjshëm dhe i aftë për të paguar, që do të përfshijë negociata të zgjatura para mbylljes së kredisë do të kërkojë një klasifikim nënstandard. Nevoja për kërkesë të

kolateralit si mjet për të përmbushur detyrimin gjithashtu do të jetë bazë për një klasifikim nënstandard.

Në mungesë të ndonjë dëshmie të dokumentuar për të kundërtën, një ekspozim duhet të klasifikohet të paktën nën-standard, në qoftë se paraqitet ndonjë nga rastet e mëposhtme:

- i. Deponimet / rrjedhat e parasë në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për pagesën e bilancit të papaguar në afat prej 61-90 ditë;
 - ii. Klienti i cili ka tejkalluar për 5 përqind ose më shumë limitin e autorizuar të ekspozimeve kreditore nga banka prej 61-90 ditë pa paguar këtë tejkallim ose nëse menaxhmenti i bankës formalisht nuk e ka aprovuar këtë ngritje të limitit;
 - iii. Klienti i cili është vonuar në pagesën e kësteve të kredisë sipas kontratës (duke përfshirë interesin) prej 61-90 ditë;
 - iv. Nëse kredia apo ekspozimet tjera kreditore nuk janë paguar prej 61-90 ditë nga data e skadimit të tyre.
- d. Kreditë e dyshimta** përfshijnë ekspozimet të cilat bazuar mbi një rishikim të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë , përmbajnë të gjitha dobësitë që janë të natyrshme në një kredi nën standard, por të cilat theksojnë se ekziston një probabilitet i madh se një pjesë e rëndësishme e shumës së kryegjësë nuk do të paguhet. Ka mundësi të humbjes, por shuma e saktë nuk mund të jetë e përcaktuar qartë në kohën e rishikimit ose varet nga ndodhja e një veprimi ose ngjarje në të ardhmen. Megjithëse, mundësia e humbjes këtu është jashtëzakonisht e lartë, për shkak të faktorëve të rëndësishëm të pazgjidhur, në mënyrë specifike të arsyeshëm të cilat mund të pritet të ndikojnë në të mirë dhe në forcimin e pasurisë, klasifikimi i tij si një humbje shtyhet deri sa të përcaktohet statusi më i saktë i tij. Shembujt të tillë të faktorëve të pazgjidhur përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në bashkimet, blerjet, ristrukturimet kapitale, ofrimi i kolateralit të ri ose plane reale të ri financimit. Garantuesit të cilët nuk bashkëpunojnë ose ata që janë në gjendje të dobët financiare nuk duhet të konsiderohen të aftë për të mbështetur pagesën e kredisë. Mbështetja në kolateralin në dispozicion i cili nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar shumën e borxhit mund të justifikojë një klasifikim të dyshimtë.

Në mungesë të ndonjë dëshmie të dokumentuar për të kundërtën, një ekspozim duhet të klasifikohet të paktën i dyshimtë, në qoftë se paraqitet ndonjë nga rastet e mëposhtme:

- i. Deponimet / rrjedhat e parasë në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për pagesën e bilancit të papaguar në afat kohor prej 91- 180 ditë;
- ii. Klienti i cili ka tejkalluar për 5 përqind ose më shumë limitin e autorizuar të ekspozimeve kreditore nga banka në afat kohor prej 91-180 ditë pa paguar këtë tejkallim ose nëse menaxhmenti i bankës formalisht nuk e ka aprovuar këtë ngritje të limitit;
- iii. Klienti i cili është vonuar në pagesën e çfarëdo kësti të kredisë sipas kontratës (duke përfshirë interesin) në afat kohor prej 91-180 ditë;
- iv. Nëse ka dobësi në gjendjen financiare të klientit që kanë shkaktuar humbje në kapital.
- v. Nëse kredia apo ekspozimet tjera kreditore nuk janë paguar në afat kohor prej 91-180 ditë nga data e skadimit të tyre.

- e. **Kreditë Humbje** përfshijnë ekspozimet të cilat, bazuar mbi një rishikim të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, kanë vlerë të vogël apo do të kërkojnë një periudhë të gjatë për të realizuar ndonjë vlerë. Një ekspozim duhet të klasifikohet humbje, në qoftë se paraqitet ndonjë nga rastet e mëposhtme:
- i. Deponimet / rrjedhat e parasë në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për pagesën e bilancit të papaguar në afat kohor mbi 180 ditë;
 - ii. Klienti i cili ka tejkalluar për 5 përqind ose më shumë limitin e autorizuar të ekspozimeve kreditore nga banka më shumë se 180 ditë pa paguar këtë tejkallim dhe nëse menaxhmenti i bankës formalisht nuk e ka aprovuar këtë ngritje të limitit;
 - iii. Klienti i cili është vonuar në pagesën e çfarëdo kësti të kredisë sipas kontratës (duke përfshirë interesin) më shumë se 180 ditë;
 - iv. Nëse kredia apo ekspozimet tjera kreditore nuk janë paguar më shumë se 180 ditë nga data e skadimit të tyre.

Neni 8

Ri programimi i Ekspozimeve Kreditore

1. Bankat duhet të bëjnë ri programimin e ekspozimeve kreditore vetëm në bazë të përmirësimit të faktorëve kreditor. Banka nuk duhet t'i ri programojnë ekspozimet me vonesa vetëm për të shmangur kërkesat për klasifikim dhe provizionim. BQK-ja e konsideron një praktikë të tillë si mashtruese dhe jo të shëndoshë. Nëse ndonjë praktikë e tillë evidentohet nga BQK-ja, ajo do të rezultojë me një vlerësim të pakënaqshëm për menaxhmentin e asaj banke.
2. Menaxhmenti i bankës duhet të dokumentojë në dosjen kreditore të çdo personi që ka një ekspozim ndaj bankës, bazat për riprogramimin e ekspozimit kreditor dhe duhet të përgatisë një listë të ekspozimeve të riprogramuara për rishikim periodik nga bordi i drejtorëve ose komiteti i menaxhimit të rrezikut. BQK-ja gjatë ekzaminimeve në vend të bankave gjithashtu do të rishikojë listat e ri programimeve dhe dosjet përkatëse të tyre në mënyrë që të vërtetojë praktikën dhe politikën e ri programimit të bankave.
3. Bankave iu ndalohet kapitalizimi i interesit në vonesë në shumën e kryegjësë së çdo ekspozimi kreditor ose krijimin e një ekspozimi shtesë ndaj një personi apo një interesi të ndërlidhur të atij personi në mënyrë që të paguajë interesin në vonesë. Prandaj, me rastin e riprogramimit të një ekspozimi kreditor bankës i lejohet të trajtojë interesin në vonesë, me anë të përpilimit të një plan pagese pa kamatë, e cila përfshinë një periudhë të arsyeshme..
4. Ekspozimet e riprogramuara duhet të (bëhen) shënohen me plan pagese, duke përfshirë kryegjënë dhe interesin. Plan i pagesave duhet t'i përshtatet natyrës së biznesit të huamarrësit.
5. Ekspozimet kreditore të ri-programuara duhet të klasifikohen të paktën në kategorinë nën standard apo më keq dhe duhet të vazhdojnë të klasifikohen në kategorinë e njëjtë deri sa të vërehet një performancë e qëndrueshme. Pas përfundimit të çdo periudhe të performancës së qëndrueshme, banka mund të klasifikojë ekspozimet kreditore të ri-programuara për një kategori më mirë.

Neni 9

Trajtimi i Kredive të Shumta për një Huamarrës të Vetëm ose Grupi të Huamarrësve të Ndërlidhur

1. Çdo lejim i kredisë për një huamarrës ose grup të huamarrësve duhet që në mënyrë të ndarë të vlerësohet dhe klasifikohet në bazë të meritave dhe faktorëve të lidhur me ekspozimin e caktuar. Megjithatë, problemet me një ekspozim shpesh janë tregues se problemet mund të shtrihen edhe në marrëdhënien me ekspozimet tjera. Prandaj, BQK-ja kërkon që të gjitha ekspozimet kreditore, duke përfshirë dhe ekspozimet jashtëbilancore, ndaj një huamarrësi duhet të klasifikohen në kategorinë e njëjtë, me përjashtim të ekspozimeve kreditore që plotësojnë kërkesat e "klasifikimit të ndarë". Gjithashtu kërkohet që bankat të kenë njohuri të plotë të marrëdhënieve të biznesit të huamarrësve të tyre dhe të kenë sistem adekuat të informimit të menaxhmentit me të cilin do të monitorojnë totalin e ekspozimeve të tyre.
2. Në rastet kur një huamarrës ose grupi i huamarrësve të ndërlidhur, kanë ekspozime kreditore ndaj institucioneve të ndryshme financiare, ekspozimet kreditore të tyre nuk duhet të klasifikohen më mirë se një kategori nga klasifikimi më i dobët i tyre me përjashtim të ekspozimeve kreditore, që plotësojnë kriteret e klasifikimit "të ndarë". Kjo vlen vetëm për kreditë që vlerësohen në mënyrë individuale nga banka, Kriteri i materialitetit, i cili duhet të aplikohet me rastin e klasifikimit më të mirë se një kategori nga klasifikimi më i keq të ekspozimit kreditor të huamarrësit vetëm në një institucion financiar është shuma mbi 5,000 Euro.
3. Me rastin e klasifikimit të ekspozimit kreditor të ri programuar të huamarrësit në një kategori më të mirë, duhet të merret parasysh performanca e qëndrueshme, ndërsa me rastin e klasifikimit të ekspozimit kreditor të huamarrësit në një kategori tjetër duhet të merret parasysh klasifikimi më i dobët në institucionin tjetër financiar.
4. Bankat duhet të dokumentojnë dhe të analizojnë të gjitha marrëdhëniet brenda portofolit të tyre dhe të abstenojnë nga kreditimi për përfitim të palës tjetër, për të anashkaluar limitet e kredive të kërkuara nga rregulloret apo kërkesat tjera të BQK-së apo të fsheh përfituesit e fundit të fondeve të kredive. Dështimi për të dokumentuar siç duhet këto marrëdhënie konsiderohet si një praktikë jo e shëndoshë bankare. Aksionarët, drejtorët dhe zyrtarët e bankave që fshehin me dashje ose dështojnë të zbulojnë marrëdhënie të tilla do të jenë subjekt i masave ndëshkuese nga BQK-ja, duke përfshirë këtu edhe detyrimin për të kompensuar çfarëdo humbje që bankat kanë pësuar nga ekspozimet e tilla kreditore.

Neni 10

Klasifikimet e Ndara

BQK-ja vlerëson se faktorët që lidhen me një ekspozim (vlera dhe likuiditeti i kolateralit, garanci të pjesshme, burimet të ndryshme të pagesës, etj) mund të rezultojë në situata ku një pjesë e ekspozimit është e mbrojtur në mënyrë adekuate ose më mirë e mbrojtur se pjesë tjera të ekspozimit. Në situata të tilla, ku faktorët kreditor janë të dokumentuar dhe të siguruar, bankat janë të lejuara për të ndarë klasifikimet dhe të bëjnë provizionimin përkatës në mënyrë që të paraqesin më saktë rrezikun aktual kreditor.

Neni 11

Klasifikimi i Angazhimeve Jashtëbilancore dhe Detyrimet e Mundshme (Kontingjente)

1. Shqyrtimi i ekspozimeve ndaj huamarrësve individual duhet të përfshijë angazhimet jashtëbilancore dhe detyrimet e mundshme të bankave që gjithashtu paraqesin një ekspozim të huamarrësit. Kjo përfshin:
 - a. Pjesët e pashfrytëzuara të linjave kreditore dhe mbitërheqjeve të aprovuara / të parevokueshme. Këto zakonisht do të klasifikohen në të njëjtën kategori si shuma e tërhequr në këto linja, mirëpo kjo nuk vlen për linjat kreditore dhe mbitërheqjet e revokueshme.
 - b. Zëvendësuesit e kredive si garancionet, letrat kreditore në pritje, letra tregtare të kredive, apo garancione e tjera, duhet të klasifikohen duke përdorur të njëjtat standarde që përdoren për të gjykuar aftësinë kreditore të kredive që janë në bilanc të gjendjes. Në mungesë të ndonjë treguesi ose evidence për të dokumentuar të kundërtën këto ekspozime jashtëbilancore duhet të klasifikohen në të njëjtën kategori si ekspozimet e tjera të klientit të bankës.
2. Klasifikimi duhet të jetë për shumat neto nga vlera e vlerësimit aktual të kolateralit të pranueshëm.

Neni 12

Klasifikimi i Investimeve në Letra me Vlerë

1. Aksionet (letrat me vlerë të kapitalit) dhe bondet (obligacionet) duhet të klasifikohen duke u bazuar në aftësinë kreditore të emetuesit të letrave me vlerë ose sipas rastit, garantuesit ose nxitësit kreditor. Aftësia kreditore duhet të përcaktohet nga analizat e informatave aktuale financiare dhe / ose referencë të klasifikimit të letrave me vlerë të kryera nga ndonjë agjenci e njohur e vlerësimit.
2. BQK-ja i konsideron klasifikimet nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut, të barasvlershëm me vlerësimin e S&P dhe më të ulëta se BBB të jenë spekulative, andaj janë subjekt i klasifikimit. Nëse institucioni financiar nuk ka një klasifikim dhe nuk ka informacione aktuale financiare, investimi duhet të klasifikohet si "humbje" dhe të provizionohet plotësisht.
3. Përjashtim nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni bëjnë letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Neni 13

Klasifikimi i Ekspozimeve të Bankave Korrespondente

1. Të gjitha ekspozimet ndaj bankave korrespondente duhet të mbështeten nga informatat adekuate financiare dhe informata tjera kreditore.

2. Klasifikimi duhet të bazohet në faktorë të njohur që zakonisht përdoren për të analizuar institucionet financiare.
3. Përveç kësaj, ekspozimet jashtë vendit duhet të vlerësohen në aspektin e rrezikut të vendit, rrezikut të këmbimit valutor dhe rrezikut të transferit.
4. Në rast të vonesës në pagesa të interesit apo të borxhit kryesor, në mungesë të ndonjë informacioni tjetër, duhet të përdoren të njëjtat kritere si për ekspozimet tjera kreditore.

Neni 14

Klasifikimi i Pasurive kur Banka merr Titullin e Pronësisë

1. Kohë pas kohe, një bankë mund të marrë në posedim ose të fitojë titullin e pronësisë për pasuritë, për borxhet e papaguara ndaj saj. Këto pasuri duhet të regjistrohen në vlerën reale të tregut të pasurisë së përvetësuar, duke i zbritur shpenzimet e vlerësuara që kanë të bëjnë me shitjen e pasurisë dhe kredia e tillë duhet të largohet nga librat.
2. Bankat duhet t'i shesin këto pasuri sa më shpejt të jetë e mundur, por në asnjë rast nuk mund ta mbajnë më shumë se pesë vite në rastin e pronës së paluajtshme apo një vit me rastin e pronës së luajtshme, ashtu siç është specifikuar në Rregulloren për mbajtjen e pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme.
3. Pasuritë e tilla nga natyra e tyre duhet të klasifikohen jo më mirë se nënstandard dhe ndoshta edhe më keq në kohën e përvetësimit, kur mundësia e shitjes me vlerën e vlerësuar zgjatet.

Neni 15

Klasifikimi i Pasurive Tjera

1. Llogaritë e përkohshme ose llogaritë pezull, mbitërheqjet e rastit dhe llogaritë e bankave korrespondente duhet të barazohen dhe të shlyhen në baza të rregullta.
2. Bankat duhet t'i shlyejnë zërat që nuk pastrohen menjëherë pasi që mos arkëtimi i tyre të bëhet i dukshëm.
3. Në çdo rast, të gjitha mjetet e tilla duhet të shlyhen jo më vonë se 90 ditë nga data e fillimit.

Neni 16

Provizionet (Rezervat) për Sigurimin e Humbjeve nga Kreditë

1. Provizionet Specifike (Rezervat)

- a. Provizionet minimale duhet të krijohen në përputhje me paragrafin 3 të nenit 7 të kësaj Rregulloreje;
- b. Bankat duhet të ndajnë nivele më të larta të provizioneve sesa minimumi i kërkuar me këtë rregullore nëse analizat e rrezikut kreditor të ndonjë ekspozimi të caktuar kërkojnë një nevojë të tillë;
- c. Provizionet duhet të bëhen ndaj vlerës neto të ekspozimit pas zbritjes së kolateralit të pranueshëm;

- d. Provizionet minimale për kreditë e klasifikuara janë si më poshtë:

Nënstandard 20%

Dyshimtë 50%

Humbje 100%

- e. Si shtesë ndaj provizioneve minimale të pasurive të klasifikuara si më lartë, mungesa e të dhënave adekuate financiare është një dobësi serioze në shumë portofoli kreditor dhe përbën më shumë sesa një rrezik normal kreditor. Prandaj, për çdo ekspozim kreditor në shumë prej 500,000 Euro ose më shumë që nuk është i mbështetur nga pasqyrat e audituara ekzistuese financiare, Bankat duhet të ndajnë një provizion specifik prej 1 për qind të bilancit ekzistues (ose shuma totale e detyrimit, në qoftë se ajo është një angazhim i detyrueshëm ligjor). Ky provizion do të aplikohet, mirëpo në rast se ekspozimi kreditor është i klasifikuar në kategoritë Nënstandard, Dyshimtë apo Humbje, atëherë aplikohen provizionet e përcaktuara për këto kategori.
- f. Për qëllime të nën paragrafit (e) të këtij neni shprehja, "ekzistuese" nënkupton pasqyrat financiare që datojnë brenda 18 muajsh nga data e rishikimit për qëllime të provizionimit; ndërsa shprehja "të audituara" nënkupton pasqyrat financiare për të cilat auditori i jashtëm ka shprehur një opinion të pakualifikuar (pa rezervë).

2. Provizionet e Përgjithshme (Rezervat)

- a. Përveç provizioneve specifike të kërkuara ndaj ekspozimeve të klasifikuara, bankat do të ndajnë provizione të përgjithshme për portofolin e mbetur, jo të klasifikuar ose segmenteve të portofolit. Ky provizion mund të jetë ndaj vlerave bruto apo vlerave "neto të kolateralit të pranueshëm", por nëse aplikohet kjo e fundit, dokumentacioni për ekspozimet me kolateral të tillë duhet të mbahet në dosje për rishikim nga ekzaminerët e BQK-së.
- b. Provizionet e përgjithshme duhet të ndahen në bazë të përvojave historike të dokumentuara, të përshtatura për kushtet aktuale dhe të ardhme të tregut. Bankat mund të përdorin njërin nga modelet statistikore në vijim për të përcaktuar provizionet e përgjithshme: "modeli roll-rate", "mesatarja e kredive të shlyera", "analiza vintage", "analiza e regresionit", ose ndonjë model tjetër i njohur ndërkombëtarisht i cili duhet të aprovohet paraprakisht nga BQK-ja.
- c. Metodologjitë e bankave për përcaktimin e provizioneve të përgjithshme do të rishikohen nga BQK-ja gjatë ekzaminimeve në vend. Metodologjitë e tilla dhe të dhënat e këtyre metodologjive duhet të rishikohen dhe rifreskohen së paku në baza vjetore.

Neni 17

Trajtimi i Interesit të përlogaritur

1. Interesi i përlogaritur në zërat e bilancit të gjendjes së bankave do të njihet për periudhën përkatëse gjatë së cilës interesi është fituar, pa marrë parasysh kohën e pagesës së tij. Kurdo që një bankë klasifikon një ekspozim si joperformuese, pra, kur është në vonesë më shumë se

90 ditë (e cila zakonisht duhet të rezultojë në klasifikimin si i dyshimtë apo humbje), atëherë duhet të ndërpritet përllogaritja e interesit të atij ekspozimi në pasqyrën e të ardhurave. I gjithë interesi i pa arkëtuar që ka qenë i përllogaritur më parë dhe është njohur si e hyrë, duhet të largohet nga të hyrat.

2. Banka duhet të bëjë këto korrigjime në baza mujore. Rregullat e mëposhtme kanë të bëjnë me trajtimin e interesit / të hyrave për ekspozimet joperformuese:
 - a. Bankat ndalohet të përllogarisin apo kapitalizojnë interes në ekspozimet kreditore të klasifikuara si joperformuese. Interesi i pranuar nga këto ekspozime mund të njihet si e hyrë vetëm në bazë të parave të gatshme – d.m.th atëherë kur në të vërtetë i inkason. Procedura e përshkruar e kontabilitetit në kohën kur një ekspozim është kategorizuar si joperformues, bazuar në statusin e vonesave ose sa herë që ka dyshim në lidhje me mbledhjen e plotë të kryegjësë ose interesit, është se i gjithë interesi i përllogaritur por i papaguar për atë ekspozim gjatë periudhës aktuale të kontabilitetit duhet të largohet nga të hyrat. Bankat mund të përllogarisin interesin e papaguar për ekspozimet joperformuese në zërat jashtëbilancore. Nëse bankat rishikojnë dhe klasifikojnë ekspozimet e tyre në baza të përshtatshme, shumat e tilla normalisht nuk duhet të kalojnë periudhën tre mujore nga klasifikimi i ekspozimit si dyshimtë apo humbje.
 - b. Ekzaminimet e BQK-së do të rishikojnë kontabilitetin dhe raportimin e këtij zëri gjatë ekzaminimeve në vend të bankave. Dështimi i mëhershëm për të qenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara mund të përbëjë një detyrim të mundshëm (kontingjent) për Bankat. Prandaj, BQK-ja kërkon që rishikimi i portofolios kreditore, klasifikimi dhe provizionimi të bëhet me kohë dhe saktë.

Neni 18 Shlyerjet

1. Bankat duhet të zhvillojnë politika, të cilat përshkruajnë bazat mbi të cilat ekspozimet kreditore të pa arkëtuara njihen si humbje dhe shlyhen. Kur një kredi është klasifikuar në kategorinë "Humbje", banka duhet të ndajë provizione për humbje nga kreditë dhe ta shlyejë atë nga bilanci i gjendjes sipas kriterëve dhe afateve në vijim:
 - a. Ekspozimet kreditore të cilat nuk janë të mbuluara me kolateral, qoftë në formë të pengut apo në formë të hipotekës, të klasifikuara në kategorinë "humbje" duhet të shlyhen nga bilanci i gjendjes brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga periudha kur janë klasifikuar në kategorinë "humbje".
 - b. Ekspozimet kreditore të cilat janë të mbuluara me kolateral në formë të pengut, të klasifikuara në kategorinë "humbje" duhet të shlyhen nga bilanci i gjendjes brenda njëzet e katër (24) muajve nga periudha kur janë klasifikuar në kategorinë "humbje".
 - c. Ekspozimet kreditore të cilat janë të mbuluara me kolateral në formë të hipotekave, të klasifikuara në kategorinë "humbje" duhet të shlyhen nga bilanci i gjendjes brenda katërdhjetë e tetë (48) muajve nga periudha kur janë klasifikuar në kategorinë "humbje".

- d. Ekspozimet kreditore të cilat janë të mbuluara me kolateral të kombinuar, në formë të pengut dhe në formë të hipotekës, në rastet kur hipoteka mbulon mbi pesëdhjetë përqind (50%) të ekspozimit në momentin e aprovimit, atëherë për qëllimin e shlyerjes, ekspozimi kreditor duhet të trajtohet sipas paragrafit c. të këtij neni.
- e. Lista e kredive të shlyera sipas kërkesave të këtij neni duhet të raportohet në takimet e rregullta të Bordi i Drejtorëve të bankës. Ndërsa shlyerja e ekspozimeve ndaj personave të ndërlidhur me bankën duhet të bëhet vetëm me aprovimin paraprak nga Bordi i Drejtorëve të bankës.

Neni 19

Vendimet e BQK-së lidhur me klasifikimin

1. Klasifikimet e brendshme të ekspozimeve kreditore nga banka do të jenë subjekt i rishikimit dhe të riklasifikimit të mundshëm nga ana e BQK-së gjatë ekzaminimeve në vend. Dallimet në mes të klasifikimit të BQK-së me atë të bankave do të diskutohen gjatë ekzaminimeve në vend, por pas diskutimeve të tilla, vendimi i klasifikimit të BQK-së do të jetë përfundimtar për të gjitha qëllimet. Prandaj, ekspozimet kreditore të cilat janë klasifikuara gjatë ekzaminimit të BQK-së, mund të klasifikohen për në një kategori më të mirë nga banka, vetëm me rastin e plotësimit të kriterit të performancës së qëndrueshme. Ndërsa me rastin e klasifikimit të humarrësit në një kategori më të dobët nga banka nuk duhet të merret parasysh performanca e qëndrueshme e huamarrësit, por duhet të respektohen kërkesat e nenit 9 paragrafi 2.
2. Çdo ndryshim i klasifikimit të kredive në një kategori më të mirë nga banka, të cilët kanë qenë subjekt rishikimi nga ekzaminimi i BQK-së që përfshinë periudhën ndërmjet ekzaminimeve të BQK-së, kërkohet të raportohen në baza tremujore në BQK.

Neni 20

Ri-regjistrimi i pasurive

1. Bankat duhet të kenë një politikë që rregullon ri regjistrimin e pasurive të shlyera më parë. Banka mund të kthejë provizionin dhe të ri regjistrojë pasurinë përkatëse vetëm atëherë kur ajo mund të demonstrojë në mënyrë të kënaqshme se kualiteti i pasurisë është përmirësuar.
2. Për çdo ekspozim të tillë që e tejkalon 5 përqind të kapitalit të klasit të I-rë, bordi i drejtorëve i bankës ose komiteti i menaxhimit të rrezikut duhet që ta aprovojë reregjistrimin e mjeteve paraprakisht.
3. Aprovimi nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të regjistrohet në procesverbalet e mbledhjes së bordit të drejtorëve ose komiteti i menaxhimit të rrezikut dhe duhet të tregojnë faktet e përmirësuar dhe rrethanat që e justifikojnë reregjistrimin.
4. Pasuritë e reregjistruara do të vlerësohen nga ekzaminerët e BQK-së në baza individuale dhe pasuritë e reregjistruara duhet të:

- a. plotësojnë kriteret e përdorura në dhënien e kredive të reja në pajtim me politikat kreditore të bankave;
 - b. të mos lejohen me kushte më të favorshme se sa ato që ekzistojnë për huamarrës të ngjashëm që janë në gjendje të mirë kreditore me institucionet financiare dhe
 - c. të mos jetë subjekt i klasifikimit.
5. Nëse të gjitha kushtet e mësipërme nuk janë plotësuar, pasuria nuk duhet të reregjistrohet.

Neni 21

Njohja e kolateralit

1. Kolaterali duhet të merret në konsideratë në procesin e klasifikimit. Vlera reale e tregut të kolateralit dhe vlera e likuidimit të kolateralit duhet të dokumentohen nga një vlerësim aktual i bërë nga një palë kompetente. Aftësia e bankave për ta përvetësuar (përdorur) dhe për ta likuiduar kolateralin brenda një periudhe të arsyeshme gjithashtu duhet të merren parasysh.
2. Shuma e klasifikuar duhet të jetë gjithmonë shuma neto e vlerës së kolateralit të pranueshëm.

Kolaterali i pranueshëm definohet si:

- a. Kolateral në para të gatshme ose bilancet e mbledhura plotësisht në llogaritë depozitarë të cilat janë në posedim të Bankave dhe subjekt i ekzekutimit të marrëveshjes së kolateralit në mënyrë valide;
- b. Çdo depozitë në para të gatshme e mbajtur në bankë për të siguruar një letër kredi ose garancion;
- c. Letrat me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës në atë masë që vlera e tregut të këtyre letrave me vlerë është të paktën 100% e ekspozimit me kusht, që të ato janë në posedim të bankës dhe janë subjekt i ekzekutimit të marrëveshjes së kolateralit në mënyrë valide, si dhe janë rivlerësuar në baza të rregullta;
- d. Letrat me vlerë të emetuara ose të garantuara nga vendet me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut, të barasvlershëm me vlerësimin e S&P “A” ose më të mirë apo bankat e tyre qendrore në atë masë që vlera e tregut të këtyre letrave me vlerë është të paktën 100% e ekspozimit, me kusht që ato të janë në posedim të bankës dhe janë subjekt i ekzekutimit të marrëveshjes së kolateralit në mënyrë valide, si dhe janë rivlerësuar në baza të rregullta;
- e. Letra tjera me vlerë të tregtueshme të lëshuara nga institucione financiare të vlerësuara nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut, të barasvlershëm me vlerësimin e S&P “A” ose më mirë (aksionet apo bonde që janë të listuara dhe tregtohen në mënyrë aktive në një shkëmbim të organizuar për të cilën çmimet e tregut mund të merren lehtë) në masën që vlera e tregut e këtyre letrave me vlerë është të paktën 125% e ekspozimit, me kusht që letrat e tilla me vlerë janë në pronësi të bankës, dhe janë subjekt i ekzekutimit të marrëveshjes së kolateralit në mënyrë valide, si dhe janë rivlerësuar në baza të rregullta;
- f. Një garancion i pakushtëzuar nga një institucion tjetër financiar që është vlerësuar nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut, të barasvlershëm me vlerësimin e S&P “A”

3. Llojet e tjera të kolateralit nuk duhet të zbriten nga shuma e ekspozimit për qëllim të klasifikimit. Megjithatë, ky kolateral, gjendja e tij qasja dhe vlera, nëse zbatohen realisht mund të jenë faktorë në përcaktimin e ashpërsisë së klasifikimit të ekspozimit.

KAPITULLI IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 22 Raportimi në BQK

Bankat do të raportojnë në BQK klasifikimin e kredive dhe të pasurive të tjera të cilat prodhojnë rrezik kreditor, si dhe krijimin e rezervave për provizionimet e humbjeve nga kreditë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren për raportimin e bankave.

Neni 23 Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Bankat.

Neni 24 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja për menaxhimin e rrezikut kreditor e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 10 maj 2013 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 25 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 30 qershor 2017.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci